



# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Bashkangjituni!

### Takimi i Rregullt i RrGGK

2 Qershor, 11-13 Hotel Prishtina

### Data e Fundit për Aplikim në FGK

30 Maj.

### Femmes Fatales

27 – 31 Maj, Prishtinë

## Në këtë numër

### Fondi i Grave Aprovoi Tetë

Grante.....2

Qytetarët Marshojnë për Zbrardhjen e Fatit të Personave të Pagjetur.....2

Gratë në Politikë dhe shoqëri Civile Krijojnë Strategji për Avokim.....3

Aktivistët Mësojnë Teknika për Video Aktivizmëm.....3

RrGGK Mbështet Institucionalizimin e Buxhetimit Gjinator.....4

80 Gratë nga 15 Vende Ridefinuan Suksesin.....4

Studentet nga Unversiteti i Amsterdamit Vizitojnë RrGGK.....4



Faqja në Facebook



Lista për dërgesat e E-lajmeve

## Top Channel Shqyrton Krimet e Pandëshkuara ndaj Grave Gjatë Kohës së Luftës

Në programin Exclusive, televizioni Top Channel ka shfaqur dokumentarin dy pjesësh "Krimi i padënuar që flet" me 20 dhe 27, Prill, autore e së cilit ishte Valdete Osmani.

Në këtë dokumentar u zbuluan dëshmi të rralla nga gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë.

Dëshmitë e tyre nuk janë përdorur mjaftueshëm në procesin gjyqësor kundër ish-udhëheqësve të Jugosllavisë, sipas [Top Channel](#).

Edhe pse ndjeshmëria e krimit ka penguar gratë që të paraqiten, mijëra gra dhe vajza besohet të kenë përjetuar dhunën seksuale nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, sipas [Center for Protection of Women and Children](#) (CPWC).

Dhunimi konsiderohet si një krim lufte, krim kundër njerëzimit dhe si një akt themelor i genocidit, në bazë të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1820 të dhunës seksuale kundër civilëve në Konflikt. Megjithatë, Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY) ka ende nuk ka dorëzuar as edhe një dënim të vetëm për personat që kanë kryer këto krime në Kosovë.

Një ditë, pasi Top Channel shfaqti pjesën e parë të dokumentarit, emisioni televiziv "Shqip" organizoi një diskutim mbi të njëjtën temë. Igballe Rogova, Feride Rushiti Albana Gashi dhe Veprorre Shehu përfaqësuan shoqërinë



Valdete Osmani, Feride Rushiti, Time Kadriaj, Igballe Rogova, Albana Gashi dhe Veprorre Shehu gjatë emisionit "Shqip".

civile, Time Kadriaj foli si anëtare e Parlamentit të Kosovës, dhe Valdete Osmani u paraqitën si gazetare të Top Channel, ku Valdete Osmani e cila ishte edhe autore e dokumentarit. "Na u desh rreth 1 vit për ti bindur gratë të flisnin, ka treguar Osmani. I bindëm se zërat e tyre nuk do të identifikoheshin. Kjo, pasi në raste të tjera identiteti i tyre është keqpërdorur. Pasi i intervistova viktimat, mësova shumë histori të trishtueshme. Vetëm t'i intervistojta ishte një torturë psikologjike"

Sot, kujtimet e tyre janë më të gjalla se vet plagët e dhunimit. Lufta për to nuk ka mbaruar, ka shkruar Top Channel. Ato gjithashtu komentuan mbi sfidat e realizimit të drejtësisë pas kaq shumë viteve të përfundimit të luftës. Dëshmitarët dhe provat janë më të vështira për t'u siguruar.

Më tej, aktivistet e të drejtave të grave e kanë akuzuar Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për zhdukjen apo e provave të këtyre krimeve që grupet e grave kishin mbledhur menjëherë pas luftës.

## Fondi i Grave Aprovoi Tetë Grante

RrGGK gjatë muajit Prill aprovoi tetë grante të Fondit të Grave të Kosovës (FGK) për organizatat anëtare. Në këtë raund aplikuan 13 organizata. Ky raund inkurajoi iniciativa që përfshijnë avokimin drejt realizimit të [qëllimeve strategjike të RrGGK-së](#), të identifikuar nga anëtarët e saj në Planin Strategjik të RrGGK për 2011-2014. Anëtarët e RrGGK propozuan disa iniciativa avokuese që përfshijnë institucionet lokale dhe kombëtare.

Vendimet për financim janë bërë nga Komisioni për shqyrtimin e granteve të Fondit të Grave të Kosovës, i zgjedhur nga anëtarët e RrGGK-së. Organizatat të cilat pëëftuan këtë raund janë:

1. [Femrat Aktive të Gjakovës](#) do të organizojnë sesione informative për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Gjakovë për ligin për dhunë në familje, dhe se si ata mund të përdorin këtë ligj për mbrojtjen e tyre. FAGJ poashtu do të monitorojë implementimin e këtij ligji dhe do të organizoi një debat ku do të paraqesin të gjeturat e tyre. (2.780)
2. [Vita-Jeta](#) do të avokojë te insitucionet shëndetësore për 600 pensionere për të bërë vizita dhe kontrolle për osteoporozë. Ndërkohë, ato do të përgatisin gratë pensioniste për avokim në lidhje me zbatimin e ligjit pas daljes në pension dhe ligjit për kujdesin shëndetësor dhe sigurim shëndetësor, i cili pritet të miratohet në vitin 2015, që do të sigurojë falas kontrollet për osteoporozën në të ardhmen, (€2.812)
3. [Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim](#) do të mësojë dhe përfshijë gratë nga Novobërda për të avokuar në komunën e Novobërdës për siguruar transport pa pagesë për banorët e kësaj komune, (€2.665)
4. [Violetë](#) do të promovojë vajzat e komunitet Rom në fshatin Prugoc, komuna e Prishtinës të cilat janë të suksesshme në shkollë duke i bërë lidere dhe model dhe për të motivuar vajzat tjera për të vazhduar edukimin. Lideret do të jenë pjesë e një iniciative të avokimit, "Ballkan Spring", ku do të prezantojnë punimet e dorës të punuara nga prindërit e vajzave për të ngritur fonde, për të mbështetur edukimin e vajzave dhe për të përmirësuar integrimin në sistemin edukativ të Kosovës, (€2.780)
5. [Shqiponjat e Dardanës](#) do të organizojnë për gratë e Graçanicës se si të jenë aktive në politikë duke i informuar ato për të drejtat e tyre politike, duke krijuar këshillat e grave të fshatit, duke organizuar takime në mes të tyre dhe të të gjitha partive politike dhe duke krijuar një strategji të qartë për funksionimin e këshillit të fshatit për një vit. (2.804)
6. [Femra vizionare e shekullit XXI](#) do të ngris vetëdijen e banorëve të Hasit të Komunës së Prizrenit dhe Gjakovës rreth sëmundjës të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës duke përmes mediave lokale. Ato gjithashtu do të avokojnë për një njësit mobil shëndetësor për të vizituar këto dy rajone dhe do të organizojë një aksion për të mbështetur 10 gra nga rajoni të cilat janë duke vuajtur nga sëmundje kancerogjene, (€2.885)
7. [Partners Kosova](#) do të organizojë mbledhje me gra, burra dhe zyrtarë për barazi gjinore dhe përfaqësues të institucioneve gjyqësore vendore në Skenderaj, Drenas, Lipjan dhe Ferizaj për të diskutuar për të drejtat e grave në trashëgimi të pronës, (€2.880)
8. [Norma](#) do të organizojë hulumtime në pesë komuna, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për procedura të pakontestueshme në vitin 2013, (€2.810)  
Raundi i pestë është financuar nga [Kvinna till Kvinna](#) (KTK) dhe Ipko Foundation, gjithsej €22,416. Fondi gjithashtu mbështet nga Austrian Development Agency. Data e fundit për aplikim për raundin e ardhshëm do të jetë me 30 Maj.

## Qytetarët Marshojnë për Zbardhjen e Fatit të Personave të Pagjetur

Çdo vit, më 27 prill qytetarët mblidhen në fshatin Mejë të Komunës së Gjakovës për të kujtuar 376 gratë, burrat dhe fëmijët civilë të cilët ishin masakruar nga ushtria serbe më 27 Prill 1999. Këtë vit Thirjet e Nënave organizuan një marsh nga Gjakova në Mejë, qte marshojnë së bashku me Kryetarën e Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila.

Qindra zyrtarë, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të rinjë marshuan gjashtë kilometra për të sjellë vëmendjen për faktin se çështja e personave të humbur, vazhdon të mbetet e pazgjidhur. [RrGGK](#) dhe organizatat e saj anëtare poashtu janë bashkangjitur marshit për të treguar solidaritetin e tyre.



Qytetarë marshojnë për zgjidhjen e fatit të personave të pagjetur. 27 Prill.

## Gratë në politikë dhe Shoqëri Civile krijojnë strategji për Avokim

Pesëdhjetë gra nga 10 komunat e Kosovës u takuan në Durrës, Shqipëri më 28-30 mars të fuqizojë njëra-tjetrën dhe të identifikohen iniciativa advokuese në të cilën ata do të bashkëpunojnë në vitin 2014. Takimi mbledhi së bashku anëtarët e asambleve komunale dhe përfaqësueset e shoqërisë civile të cilët janë të përfshira në grupet e avokimit për barazi gjinore në komunat: Prizren, Gjilan, Novobërd, Obilic, Dragash, Ferizaj, Viti, Drenas, Lipjan dhe Vushtrri. Këto grupe të shërbejnë si platformë nëpër parti politike dhe ndarje sektoriale, duke bashkuar gratë që të avokojnë së bashku për prioritet e grave në nivel komunal.

Takimi filloi me një diskutim mbi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis grave në shoqërinë civile dhe atyre që janë të përfshira në politikë. Pjesëmarrësit ripohuan angazhimin e tyre në GAG, veçanërisht në kontekstin e zgjedhjeve të fundit komunale, pas të cilave disa anëtarë të GAG kanë ndryshuar. Pjesëmarrëset u pajtuan që GAG ofron një hapësirë për gratë të fuqizojnë njëra-tjetrën.

"Nuk është e lehtë të jesh një grua politike, por nëse punoni me përkushtim mund të keni sukses," tha Valentina Bunjaku-Rexhepi, Kryetare e Kuvendit në Gjilan, në fjalimin e saj për ti fuqizuar gratë që të vazhdojnë punën e tyre. Anëtarët e GAG pastaj u ndanë në grupe punuese që ti identifikojnë prioritetet e grave brenda komunave të tyre. Secili grup identifikoi një listë me tri çështje me prioritet për të cilat planifikojnë të avokojnë së bashku në vitin 2014. Ato pastaj identifikuan strategjitë e avokimit të përbashkët.

Pjesëmarrëset falënderuan RrGGK-në për krijimin e një hapësirë ku ato mundën të marrin veten së bashku nga zgjedhjet e fundit komunale, të reflektojnë mbi mësimet e nxjerra nga zgjedhjet dhe të krijojnë solidaritet nëpër divizionet e partive politike. "Gjatë qëndrimit tonë këtu, kurrë nuk kemi menduar as edhe për një herë kush nga cila parti politike është" tha një pjesëmarrëse. "Në vend të asaj, ne të gjitha punuam së bashku në solidaritet dhe patëm një hapësirë për të folur si gra. Ka qenë shumë fuqizuese.

Në mbrëmje, RrGGK shfaqti filmin "*Engjujt e Hekurt*", i cili tregon historinë e luftës së grave për të drejtën e votës në Shtetet e Bashkuara. Filmi përmban mesazhe të rëndësishme për solidaritetin e grave përtej ndarjeve politike, fuqizimin e grave dhe strategjitë për avokim. Pjesëmarrëset u entuzazmuan dhe fuqizuan aq shumë nga filmi se që kërkuan mbështetje nga RrGGK për ta shfaqur filmin në komunat e tyre.

Që atëherë, filmi është shfaqur në Lipjan, Vushtrri dhe në komunën e Prizrenit për audience e cila ka përfshirë gra dhe burra anëtarë të kuvendit, zyrtarë dhe qytetarë. Komunat kanë dhuruar me kënaqësi hapësira për shfaqjen. Dokufest ofroi teatrin e tij pa pagesë, i cili zakonisht jepet me qira për 150 €. Filmi do të shfaqet në shtatë komuna tjera gjatë muajit maj. Ndërkohë, gjatë takimeve të organizatës për shfaqjen e filmit, RrGGK vazhdon të mbështesë GAG në çdo komunë të bëjnë strategji për iniciativat advokuese që i kanë planifikuar dhe identifikuar në Durrës. Puna e RrGGK-së me GAGs është mbështetur nga Austrian Development Agency.

## Aktivistët Mësojnë Teknika për Video Aktivizmëm

Si pjesë e projektit "Active Girl for Equal Society" Eomen's Association nga Krushevcit në bashkëpunim me Alternative Girls Center ka organizuar një trajnim për video aktivizëm për vajza nga regjioni. (Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia Mali i Zi dhe Serbia). Ky trajnim u mbështet nga Kvinna till Kvinna.

Trajnimi mbledhi së bashku më shumë se 20 participante në Vrnjacka Banja nga 10 deri 13 Prill, duke ndërtuar kapacitete të vajzave dhe duke kontribuar në lëvizjen e grave. Po ashtu forcoi lidhjet mes vajzave të regjionit. Asistentja për Mardhënie me Publikun Donjeta Berisha ishte njera nga participantet.

"Të punosh me vajza është një eksperiencë e veçantë, ato kanë energji pozitive, motivim dhe punojnë për të drejtat e grave," tha Aleksandra Nesotrov, facilitatore. "Trajnimi në Vrnjacka Banja ishte po ashtu i veçantë për mua sepse pata nderin të takoj vajza nga Kosova dhe Shqipëria."

Në ditën e parë, participantet mësuuan për video aktivizëm, metodat e filmimit dhe si të xhirojnë. Në ditën e dytë participantet u ndanë në dy grupe për të xhiruar filma të shkurter. Ato filmuan në lokacione të ndryshme, pastaj ato edituan filmimet e tyre me ndihmën e facilitatoreve.

"Unë kurrë nuk kam filmuar, nuk kam krijuar storie për të bërë ndryshime që kam dashur." Tha Aleksandra Bujchevska, participante nga Maqedonia. "

Tani unë jam në gjendje të përdor kreativitetin tim për qëllime të duhura."



Nada Pleskonjic, facilitatore tregon rëndësinë e video aktivizmit gjatë trajnimit.

## RrGGK Mbështet Institucionalizimin e Buxhetimit Gjinor

Në prill 2014 RrGGK filloi një iniciativë të re në bashkëpunim me [GIZ](#): Pilotimi i integritit të buxhetimit gjinor në proceset buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunëm e Kamenicës.

Kjo iniciativë ka për qëllim për të futur treguesit specifik gjinore në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhetin e Kosovës.

RrGGK ka bashkëpunuar me ekspertën ndërkombëtare Dr. Elisabet Klatzer dhe zyrtarë qeveritarë për të zhvilluar një udhëzues praktik për futjen e buxhetimit gjinor në procesin e buxhetit për Ministrinë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Kamenicës. Si hap i parë në të shfrytëzuar këtë udhëzues, RrGGK është duke punuar ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të kryer një auditim gjinor të buxhetit të kësaj ministrie. RrGGK gjithashtu do të mbështesë Komunën e Kamenicës në pilotimin këtë qasje.

Informacionet e nxjerra nga ky hulumtim do të informojnë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Buxhetin e Kosovës për vitin 2015 për të siguruar që buxheti i Kosovës më mirë adresoi nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë.

Kjo iniciativë kontribuon në realizimin e [Planit Strategjik RrGGK-së për 2011-2014](#).

Gjithashtu do mbështetet në përvojën paraprake RrGGK-së lidhur me Buxhetim gjinor, duke përfshirë hulumtimin e bërë në vitin 2012 të RrGGK-së për shpërndarjen e [buxhetit për zbatimin e ligjit](#) dhe strategjinë kundër dhunës në familje.

## 80 Gratë nga 15 Vende Ridefinuan Suksesin

*"Invest for Future (ITFF) #Success: Defining it in her Own Terms"* (#Suksesi: Definimi në kushtët e saj) Konferenca nga Invest For Future ka mirëpritur afërsisht 80 participante që veprojnë në sfera të ndryshme duke përfshirë avokate, aktiviste, lidere të politikës, studiuese dhe edukatore nga Anglia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kanadaja, Kroacia, Gjeorgjia, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara, përfshirë dhe përfaqësuesën nga RrGGK Nertila Qarri-Gërguri. Konferenca u mbajt nga 7 deri me 9 mars në Zagreb.

Shkolla e Ekonomisë dhe Menaxhmentit Zagreb organizoi këtë konferencë me mbështetjen e Departamentit Amerikan i Shtetit dhe Ministria Kroate e Ndërmarrësisë.

Pjesëmarrja në konferencë ishte një përvojë shumë e mirë, si të gjitha gratë kishin informacione dhe suksese për të ndarë," tha Nertila Qarri-Gërguri. "Unë gjithashtu pata mundësi të ndaj përvojën time të punës në RrGGK që ka 77 organizata anëtare. Konferenca identifikuar sfidat e përbashkëta dhe zgjidhjet e mundshme.

Kjo përfshinte mënyrat për të mobilizuar burime jo të financuara drejt qëndrueshmërisë: rrjetëzim për të ndarë metoda për organizuar evente me vetëfinansim.

Ngjarja rezultoi në një iniciativë të re, që përfshin koordinatorët e rinjë të vendeve dhe qëllimin e përbashkët për promovimin e përfshirjes së grave duke paraqitur anëtarët dhe ndikimin e tyre ekonomik, kulturor, politik dhe social në shoqëri.

## Studentet nga Universiteti i Amsterdimit Vizitojnë RrGGK

Studentet nga Universiteti i Amsterdimit, që studjojnë në departamentin e të drejtave të njeriut në Holand, vizituan zyret e RrGGK-së me 28 Prill.

Ato ishin të interesuara të mësojnë më shumë për të aktivitet e të drejtave të grave në Kosovë.

Drejtorja Egzekutive Igballe Rogova informoi studentet për punën e RrGGK, historinë e lëvizjes së grave në Kosovë. [Raportin mbi Monitorimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325](#) në Kosovë. Si dhe për edukimin në Kosovë.



Studentet nga Universiteti i Amsterdimit vizitojnë RrGGK-në me 28 Apr.